Telefoni: +383 (0)38 221 243 e-mail: [illegible]

...ektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të eficiencës së energjisë dhe ti përshtatet ambientit përreth;

- Të kihet kujdes në mbrojtjen e dobive natyrore;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret & parametrat urban të Planit Rregullues "Tophane".

VI. Kompensimi/shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesëve të parcelave kadastrale, sipas kalkulimeve në paragrafin V., parcelat ndërtimore të komplekseve me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të Bllokut urban "T4", është:

për "Grupi – faza 1", ku duhet të bëhet shpronësimi i parcelave/pjesëve të parcelave kadastrale nr.4290-0 me sip. prej 84m², nr.4291-0 me sip. prej 47m², nr.4292-0 me sip. prej 26m², nr.4293-0 me sip. prej 77m², nr.4294-1 me sip. prej 54m², nr.4294-2 me sip. prej 31m², nr.4295-0 me sip. prej 5m², nr.4296-0 me sip. prej 1m², nr.4297-0 me sip. prej 19m², dmth. gjithsejtë 344.0m², të përfshirë në hapësira publike të planifikuara, rrugë publike, do të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin V., parcela ndërtimore për "grupi-faza 1", brenda bllokut urban "T4" është me sipërfaqe prej S=2039m², dhe bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe është S=2039 x 0.2=407.8m², të lejuar e që është kjo sipërfaqe është 344m² në rastin konkret. Sipas këtij kalkulimi kjo sipërfaqe është S=16.87%, andaj pronarët dhe investitori për sipërfaqen e theksuar, për "Grupi – faza 1", gjegjësisht në "Objekti 1A" dhe "Objekti 1B", do të kompenzohen me sipërfaqe ndërtimore: **S=344 x 4.0=1376m²**;

për "Grupi – faza 2" ku duhet të bëhet shpronësimi i pjesëve të parcelave kadastrale nr.4284-0 me sip. prej 25m², nr.4285-0 me sip. prej 13m², nr.4286-0 me sip. prej 58m², dmth. gjithsejtë 96m² të përfshirë në hapësira publike të planifikuara, rrugë publike, do të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin V., parcela ndërtimore për "grupi-faza 2", brenda bllokut urban "T4" është me sipërfaqe prej S=1506m², dhe bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe është S=1506 x 0.2=301.2m², të lejuar e që është kjo sipërfaqe është 96m² në rastin konkret. Sipas këtij kalkulimi kjo sipërfaqe është S=6.8%, andaj pronarët dhe investitori për sipërfaqen e theksuar, për "Grupi – faza 2", do të kompenzohen me sipërfaqe ndërtimore: **S=96 x 4.0=384m²**;

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me koeficient ndërtimi të pjesëve të parcelave të lartcekura, bazuar në vendimin e lartcekur. Procedura e kompensimit/shpronësimit me koeficient ndërtimi, të pronës private, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të sherbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarëve të parcelave kadastrale dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i procedurës së paraparë sipas paragrafit V, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, do ta obligojë <u>*Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.*</u>

VII. **KËMBIMI** i pronës private me pronë komunale, konkretisht këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale nr.4287-0, 4288-0 dhe 4289-0 ZK Prishtinë, në pronësi të Bahrije Pakashtica, Mustafa Pakashtica dhe Ahmet Pakashtica /parcelë me kusht për aplikim për leje ndërtimi për "Grupin-faza 2", shih pikën XV. të këtij Vendimi/ me sipërfaqe totale prej 53m², e destinuar për rrugë të planifikuar sipas Planit Rregullues "Tophane", në Prishtinë, me pjesë të parcelës kadastrale nr.7704-0 ZK Prishtinë pjesa brenda vijës rregulluese, e destinuar për ndërtim, në pronësi të "P.SH. Rrugë KK Prishtinë", me sipërfaqe prej 52m², me destinim "Zonë e ndërtimit miks" dhe me koeficient ndërtimi 4.0" bazuar në "Kriteret bazë" të Vendimit për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit Rregullues Urban "Tophane" 01nr.35–374 dt. 03.04.2008, kurse sipas Planit Zhvillimor Urban, ka destinim "Ndërtim i lartë i përzier" me koeficient 3.0-4.0. Këmbimi bëhet në sipërfaqe të nevojshme në bazë të vlerësimit të organit kompetent për vlerësimin e pronave.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale të lartcekura, bazuar edhe në realizimin e planit rregullues urban e që konsiderohet "interes publik", andaj për

vazhdimin e procedurës për aplikim dhe pajisje me leje ndërtimore për "Grupi-faza 2", duhet të realizohet këmbimi i pjesëve të parcelave kadastrale. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, nga Drejtoria e Pronës e Komunës së Prishtinës, bazuar në kompetencat ligjore, të përgatitet dhe të nënshkruhet marrëveshja definitive për këmbim, në mënyrë që e njëjta të shërbejë si bazë juridike për ndërrimet përkatëse në evidencat kadastrale.

Procedura e këmbimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për "Grupi-faza 2" dhe pas plotësimit të kushtit në pikën XV, të këtij Vendimi, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të dt. 22.11.2012, thuhet se "Komuna ka të drejtë të këmbejë pronën e paluajtshme komunale me persona fizik dhe juridik, në rastet kur një këmbim i tillë nevojitet për sigurimin e tokës për qëllime të shfrytëzimit për interes publik".

*<u>Mos zbatimi i procedurës së paraparë sipas këtij paragrafi - pike, nga pronari dhe investitori, për arsye të ndryshme, do ta obligojë Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë këtë Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.</u>*

VIII. **Ndarja** / parcelimi i parcelave kadastrale, nr 4297-0, 4296-0, 4295-0, 4294-1, 4294-2, 4294-1, 4292-0, 4291-0, 4290-0, 4289-0, 4288-0, 4287-0, 4286-0, 4285-0, 4284-0, 4306-0 dhe 4307-0 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dispozitës urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, si dhe pëlqimit për ndarje nga bashkëpronarët për parcelat kadastrale nr.4306-0 dhe 4307-0 ZK Prishtinë.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01"*, punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa me licencë nr 09. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtij ndryshimi.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar në Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01"*, punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa me licencë nr.09, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IX. **Bashkimi** i pjesëve dhe parcelave, nr.4297-0, 4296-0, 4295-0, 4294-1, 4294-2, 4294-1, 4292-0, 4291-0, 4290-0 ZK Prishtinë, si një parcelë ndërtimore dhe pjesët/parcelat kadastrale nr.4289-0, 4288-0, 4287-0, 4286-0, 4285-0, 4284-0, 4306-0 dhe 4307-0 ZK Prishtinë si parcelë e dytë ndërtimore, me kusht që të bëhet bashkimi me parcelën ndërtimore të fazës së parë, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Tophane" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit të bashkimit të parcelave.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas parcelave ndërtimore dhe Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Tophane" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa me licencë nr.09. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operatën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi sipas grupeve-fazave të caktuara, të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, bazuar në kushtet ndërtimore, me kërkesë të pronarëve.

X. **Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*


Republika e Kosovës Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: "Rudina Zogaj" nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +381 (0) 38 221 243

- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*
- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe parajon në orlotin të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*
- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).*

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

XI. **Dokumentacioni ndërtimor** / projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndertimore, leje ndertimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.03/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinorë", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndertesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;*
- *Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionimin të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionin të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*
- *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;*
- *Detajet e nevojshme në përpjese 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*
- *Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;*
- *Projektin e strukturës së ndertimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionin dhe detaje të nevojshme;*
- *Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;*
- *Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Elaborati i "Organizimi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terren;*

XII. **Dokumentacioni ndërtimor** - Elaborati për <u>Masat e mbrojtëse nga zjarri</u> hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorezohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçante, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndertesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000.*


Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë/Kosovë
Telefoni: +381(0) 38 221 347 e-mail: [illegible]

- *Situacionin "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 [illegible] përpunuar në koordinata në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të [illegible], me tabela tekstuale dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të [illegible]*

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shtypur dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XIII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezentuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës ve dhe investitorit).*

XIV. **Pagesa e taksës** për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.05/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimit.

XV. **Kushti për realizimin e "Grupi – faza 2" –gjegjësisht "Objekti 2A" dhe "Objekti 2B"**, bazohet në nenin 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, gjegjësisht, plotësimin e kushteve si në vijim:

- me arritje të marrëveshjes për ndërtim me pronarin/ët e parcelës kadastrale nr.4286-0 ZK Prishtinë;
- rregullimi i dokumentacionit pronësor të parcelës kadastrale nr.4289-0 ZK Prishtinë;
- pëlqimi për ndarje nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale 4307-0 ZK Prishtinë, Tefik Gashi, Gjylinaze Robaj dhe Hatixhe Krasniqi;
- këmbimi i pjesëve të parcelave kadastrale jashtë vijës rregulluese të "Grupi – faza 2", me pjesën brenda vijës rregulluese të parcelës kadastrale nr.7704-0 ZK Prishtinë, në pronësi të "P.SH. Rrugë KK Prishtinë".

XVI. **Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

## Arsyetim

Kërkuesit / pronarët, Bylent Ribari, Turgay Huniler, Adeem Ribari, Sadije Hoxha, Ruzhdi Boshnjaku, Alije Ymeri, Rukije Dobrçani, Neriman Hasanxhekaj, Eroll Kursani, Edaa Nikaç, Ismet Mujeci, Adem Mujeci, Arif Emini, Sokol Emini, Raif Emini, Shefqet Emini, Enis Emini, Bahrije Pakashtica, Mustafa Pakashtica, Fatmir Morina, Mehmet Rizani, Sabrije Rizani, Mevlyde Ballovci, Xhevdet Zariq, Xhevat Zariqi, Xhelal Zariqi, Suzan Mehmeti, Shukran Hoti, Hatixhe Krasniqi, Levent Pakashtica dhe Teuta Pakashtica të gjithë nga Prishtina, me investitor NTN "Labi Com", me certifikatë të biznesit nr.70563568, me adresë në rr."Nazim Gafurri", p.nr. dhe përfaqesues/pronar Shefqet Gashi, me kërkesën, 05nr.350/02 – 0144544/18 dt.18.06.2018, kanë kërkuar nga kjo Drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste "Grupi – faza 1" – "Objekti 1A" dhe "Objekti 1B", dhe "Grupi – faza 2" "Objekti 2A" dhe "Objekti 2B", në kuader të parcelave ndërtimore, të Blokut urban "T4", të Planit Rregullues "Tophane" në Prishtinë, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0144544/18 dt.18.06.2018, kërkuesit kanë prezantuar dhe është trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelat kadastrale, nr.4284-0, 4285-0, 4287-0, 4288-0, 4290-0, 4291-0, 4292-0, 4293-0, 4294-1, 4294-2, 4295-0, 4296-0, 4297-0, 4306-0 dhe 4307-0, ZK Prishtinë dhe, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Fatmir, Afrim, dhe Fadil Boshnjakut me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.15858/18 Ref.nr.3543/18 dt. 13.08.2018;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Alije Umeri, Rukije Dobërçani, Neriman Hasangjekaj, Eroll Kursani, Edaa Nikaç, me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.16291/1, Ref.nr.3415/17 dt.31.08.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Arif, Sokol, Raif, Shefqet dhe Enis Emini me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.23830/17 Ref.nr.4953/17 dt.26.12.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Ismet dhe Adem Mujeci me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.20554/17 Ref.nr.4203/17 dt.31.10.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Mustafa Pakashtica dhe Bahrije Pakashtica me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.6268/17 Ref.nr.1520/17 dt.27.04.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Fatmir Morina me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.2000/18 Ref.nr.523/18 dt.02.02.2018;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Mehmet Rizani me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.10604/17 Ref.nr.2526/17 dt.05.07.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Sabrije Rizani me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.13492/17 Ref.nr.2843/17dt.28.07.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Mevlyde Ballovci me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.3730/17 Ref.nr.913/17 dt.14.03.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Xhevat Zariqit dhe Xhevdet Zariqit me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.11111/17 Ref.nr.2571/17 dt.10.07.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Xhelal Zariqit me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.21162/17 Ref.nr.4354/17 dt.10.11.2017;*
- *Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Shukran Hoti dhe Suzana Mehmeti me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.1345/18 Ref.nr.365/18 dt.24.01.2018;*

- Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Ruzhdi Boshnjakut me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.10022/18 Ref.nr.2405/18 dt.07.06.2018;
- Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Bylent Ribari, Turgay Huniler, Adem Ribari, Fatime Huniler dhe Sadije Hoxha me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.4879/18 Ref.nr.1152/18 dt.19.03.2018;
- Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Hatixhe Krasniqi me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.21974/18 Ref.nr.5092/18 dt.01.11.2018;
- Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor dhe afarist, e lidhur në mes të Levent Pakashtica dhe Teuta Pakashtica me inv.NTN "Labi-Com", e vërtetuar te noteri Isak H.Ademi, me LRP nr.21738/18 Ref.nr.5015/18 dt.29.10.2018;
- Kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë, në mes të Hamdi Pacolli në cilësinë e shitësit dhe Teuta Pakashtica dhe Hatixhe Krasniqi në cilësinë e blerësit, të vërtetuar te noterja Valbona Murtezi Bytyqi, me LRP.nr.3797/2018, ref.nr.1594/2018, me dt.26.09.2018;
- Autorizim dhe pëlqim i dhënë nga Hamdi Pacolli për Teuta Pakashticën, e vërtetuar te noterja Valbona Murtezi Bytyqi, me LRP nr.3800/2018 dt.26.09.2018;
- Autorizim dhe pëlqim i dhënë nga Hamdi Pacolli për Hatixhe Krasniqin, e vërtetuar te noterja Valbona Murtezi Bytyqi, me LRP.nr.3799/2018 dt.26.09.2018;
- Autorizim i përgjithshëm, i dhënë nga Ruzhdi Boshnjaku për Aslan Pllanën me LRP.nr.9032/17 Ref.2163/17 dt.09.06.2017
- Kopje e Deklaratës trashëgimore dhe autorizimit të përgjithshëm, e dhënë nga Edea Rikac, për Fetije Kursani, ehartuar në gjuhën angleze dhe e vërtetuar nëSHBA – Shteti i Floridas, me dt.17.05.2017, fotokopje e vërtetuar te noteri Isak H. Ademi me LRP nr.16281/17 dt.31.08.2017;
- Projekt propozimi konceptual – "zgjidhja urbane", punuar nga kompania projektuese "Arcadis"sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 70547090;
- Fotot e lokacionit;
- "Njoftimi publik" i datës 18.07.2018 deri më 01.08.2018;
- Informim nga Plani Rregullues Tophane dhe PZHU, 05nr.350/01-0063549/17 dt.06.04.2017, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Dokumentacioni i kompanisë investuese N.T.N. "Labi-Com", me seli në Prishtinë, me certifikatë të biznesit nr.70563568, dhe përfaqësues/pronar Shefqet Gashi;
- Fotokopja e letërnjoftimit të kërkuesve/pronarëve të parcelave kadastrale dhe investitorit;
- Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve tatimore, të pronarëve dhe investitorit;
- Incizimi gjeodezik – Situacioni i terrenit në parcelat nr.10087-1, 05876-0, 05879-0 ZK Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafe, me licencë nr.09;
- "Fesë" e datës 16.08.2018, dërguar Ibrahim Xhavi, Adile Naime, Mihane, Syzana, Ibrahim, Gazmend, Valon, Arian Jashari, Mehmet Hysës, dhe Gjorgje Milicevicit;
- Deklaratë e investitorit, e dt.30.10.2018 (e pavërtetuar te noteri)
- Manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafe, me licencë nr.09;
- Propozimi për ndarje të parcelave sipas shfrytëzimit të gjendjes faktike (me koordinata), punuar nga gjeodeti i licencuar Xhavit M. Gorcaj, me licencë nr.94;

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 0144544/18 dt.18.06.2018, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për zonën, rregullativën ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumenteve gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, konstatoi se:

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës së lartcekur me projekt propozimin e prezantuar dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 18.07.2018 ka vendosë "Njoftim publik" me projekt propozim, në vende të dukshme të lokacionit, në diametrin e dritës prej 50m', për njoftimin dhe dhënien e mundësisë pronarëve dhe poseduesve të rrethinës dhe palëve të interesuara, për dhënien e komenteve, i cili njoftim ka qëndruar deri më datë 01.08.2018, ku gjatë së cilës periudhë kanë arritur disa komente në email adresat e vendosura në njoftimin publik dhe ankesa me referencë 05-070/01-0187991/18 dt.01.08.2018, e ushtruar nga Levent Pakashtica, si bashkëpronarë në parcelën kadastrale nr.4307, i cili është ankuar për mospërfshirje në këtë "zgjidhje urbane". Sa i përket ankesave nëpërmjet e-mailit ato kanë qenë kryesisht ankesa ndaj Planit Rregullues "Tophane" dhe problemeve me infrastrukturë, veçanërisht

me ujsjellës dhe kanalizim, në të cilat zyrtari përgjegjës është përgjigjur nëpërmes e mailit zyrtar.
Pas njoftimit verbal të investitorit lidhur me ankesën e Levent Pekashticës i cili ka kërkuar përfshirje në 'zgjidhje urbane' dhe pas analizave të situacionit dhe konsultimit të Planit Rregullues, është arritur marrëveshja me dy nga tre bashkpronarët e parcelës kadastrale nr.4308-0 dhe njërin nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale nr.4307-0 ZK Prishtinë. Lidhur me këtë dhe plotësime tjera, janë bërë disa plotësime të lëndës, me referencë 05-350/02-0144544/1/18 dt.14.08.2018, 05-350/02-0144544/18/2 dt.02.10.2018 dhe 05-350/02-0144544/18/3 dt.02.11.2018.

Pas analizimit të projekt propozimit me Planin e situacionit – 'zgjidhja urbane' në raport edhe me parcelat tjera në kuadër të Bllokut urban "T4" të planit rregullues, u konstatua se parcelat në vazhdim të këtij blloku, gjegjësisht në pjesën perëndimore të saj, nr.4300-2, 4300-1, 4298-0 dhe 4299-0 ZK Prishtinë, të cilat parcela e përmbyllin bllokun në atë pjesë dhe në kuadër të të cilave përfshihen ndërtesa individuale banimore edhe lokale afariste, me etazhitet, P+3, P+0 dhe P+1, dhe të cilat me mos trajtim në këtë fazë, zgjidhja urbane e kësaj pjese të bllokut do të ishte jo gjithë përfshirëse (edhe pse kriteret e planit e mundësojnë).
Prandaj, drejtoria përmes "Ftesë" të datës 16.08.2018, ka ftuar pronarët dhe bashkëpronarët e parcelave të lartcekur, që të marrin pjesë në procedimin administrativ sipas kërkesës për caktim të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 –0144544/18 dt.18.06.2018, për t'u informuar me projekt propozimin dhe kriteret e planit rregullues dhe më pas, për t'u deklaruar lidhur me çështjen, në takimin e caktuar për datën 23.08.2018 në ora 10.00h, në zyrat e Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, në të cilën ftesë asnjëri nga të ftuarit edhe pse e kanë pranuar ftesat me dt.20.08.2018 (pos pronarit të parc. 4299-0, i cili sipas shkresës së postës shkruan se është "shpërngul"), nuk janë përgjigjur. Takimi i caktuar nuk u realizua pasi që asnjëri nga të ftuarit nuk u paraqit në zyret e kësaj drejtorie.

Pas analizimit të sërishëm të Planit situacionit - "zgjidhja urbane", në raport me planin rregullues, u konstatua se brenda bllokut urban përfshihet edhe pjesa e parcelës nr.7704-0 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P SH. Rrugë Publike KK Prishtinë, e cila sipas Planit Rregullues "Tophane" është planifikuar si zonë ndërtimore, gjegjësisht në kuadër të shiritit - zonës ndërtimore, me ndërtueshmëri 100%, prandaj me këtë Vendim e njëjta duhet të këmbehet, me sipërfaqe të pjesëve të parcelave kadastrale në trajtim me këtë Vendim, të cilat sipas Planit Rregullues "Tophane" shtrihen në hapsirën e planifikuar për rrugë publike, e cila procedurë duhet të kryhet para aplikimit për leje ndërtimore të ndërtesave shumbanesore me afarizëm të "Grupi-faza 2".

Pas konstatimeve të lartshënuara, në mbështetje të nenit 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L – 031 dt.21.06.2016, me pajtim të aplikuesve për caktim të këtyre kushteve ndërtimore dhe mos deklarimit të të gjithë pronarëve të parcelave kadastrale, u vendos që pronarëve dhe bashkëpronarëve të parcelës kadastrale nr.4286-0 dhe rregullimit të çështjeve pronësore të parcelës kadastrale nr.4289-0 ZK Prishtinë, tu jepet një afat shtesë për marrëveshje për realizimin e "Grupi – faza 2" të analizuar dhe studiuar përmes këtyre kushteve ndërtimore, sipas procedurës së përshkruar në paragrafin XIV të këtij vendimi. Bazuar në kushtin e përcaktuar, poseduesit e kushteve ndërtimore, mund të aplikojnë për pajisje me leje ndërtimore për ndërtimin e ndërtesave shume banesore dhe afariste, bazuar në dokumentacionin ndërtimor dhe rregullativën ligjore në fuqi.

Bazuar në paragrafin VI. të këtij vendimi, pronarët dhe investitori, bazuar në kërkesën e tyre, pjesët e parcelave kadastrale që përfshihen në hapësira publike (rrugë publike), mund ti kompensojnë / shpronësojnë, me koeficient ndërtimi, duke u mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008. Në bazë të shtrirjes së saj, është bërë edhe llogaritja e sipërfaqes ndërtimore që do të kompensohet, me koeficient ndërtimi 4.0, e cila sipërfaqe është e përcaktuar me manualin gjeodezik. Andaj, sipas këtij kalkulimi, pronarët dhe investitori, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore: për 'grupi-faza 1', S=344 x 4.0=1376m² dhe për 'grupi-faza 2', do të kompenzohen me sipërfaqe ndërtimore: S=96 x 4.0=384m².

Procedura e kompensimit do të realizohet në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, bazuar në paragrafin VI. të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe nëse ky obligim nuk realizohet, kjo drejtori obligohet të rishikojë kushtet ndërtimore të përcaktuara në paragrafin IV., me to edhe vendimin e kushteve ndërtimore në tërësi, sepse do të ndryshohej sipërfaqja ndërtimore, etazhiteti, etj., e ndërtesave të planifikuara.


Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Rexhvan Zogoriq" nr. 1, 10000, Prishtinë [illegible]
Telefon: +383 (0) 38 22 ? 242 e-mail: [illegible]

Paraprakisht zhvillimit të propozimit të përcaktuar në paragrafin VI të këtij Vendimi, duhet të realizohet procedura e këmbimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale, të përshkruara në paragrafin VII dhe VIII të këtij Vendimi, ku pas këmbimit, ndarjes dhe bashkimit do të krijohen parcelat ndërtimore me vijën ndarëse në mes hapësirës private dhe asaj publike-vijën rregulluese, ku do të realizohen ndërtesat e planifikuara dhe përmbajtjet tjera.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantimit në shkresën e zyrtarit për komunikacion, është përcaktuar rregullsia e kompleksit dhe kyçja e saj nga aspekti i komunikacionit, si dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren për kyçje të kompleksit në rrugën e brendshme të bllokut dhe e njëjta me rrugën e planifikuar, dhe ndër të tjera konstatohet:

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Fatime Hyniler, Bylent Riban, Turgay Huniler etj, nga Prishtina, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-0144544/18, të dt. 18.06.2018, kyçja për automjete, në rrugën e planifikuar në lagjen "Tophane", për ndërtesat e fazës së parë, objekti 1A me etazhitet 2B+P+10 dhe objekti 1B me etazhitet 2B+P+10, si dhe ndërtesat e fazës së dytë, objekti 2A me etazhitet 2B+P+9 dhe objekti 2B me etazhitet 2B+P+9, të prezantuara si në situacion, mund të pranohet si e tillë. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës edhe në kohën kur realizohet ajo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit, në fazën e shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02 – 0144544/18 dt 18.06.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore, ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit - "zgjidhja urbane" i propozuar me projekt propozimin e ndërtesave është në harmoni me destinimin dhe kriteret bazë të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesë të planifikuar, Situacioni i parcelave me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali për bashkim & ndarje, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer K.Mustafa nga Prishtina.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH.

**Ky Vendim është përpiluar në 7(shtatë) kopje identike** dhe i dorëzohet Kërkuesve, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorisë së Pronës, kësaj Drejtorie, në dosje të lëndës 05nr.350/02 – 0144544/18 dt 18.06.2018 dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 0144544/18 DT. 07.12.2018

| Zyrtari | U.D. Udhëheqëse e Sektorit | DREJTORI |
|---|---|---|
| Sazan Raskova | Lindita Beqiri | Ardian Olluri |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Komuna: Prishtinë
Zyre: Zyra kadastrale komunale

Numri i referent lëndës: 011-940/01-0089277/19

Në bazë të nenit 13, 14 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/L-013, si dhe nenit 8, 9, 12, 14, 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për zbatimin e Ligjit për Kadastër, Korniza për punë AKK 2013/02, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për bashkimin e njësisë ve kadastrale, nxjerr këtë:

# AKTVENDIM

APROVOHET – Kërkesa e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09 për bashkimin e parcelave kadastrale në pronësi të MUSTAFA (JAKUP) PAKASHTICA 1/2 , me numër personal 1004146910 dhe BAJRIJE (MUSLI) PAKASHTICA 1/2 me nr. pers. 1014596034, sikur vijon:

| Të dhënat për gjendjen e re të krijuar | Numri kadastrale | Zona Kadastrale | Vendi i quajtur | Sipërfaqja e gjithmbarshme | Lloji i shfrytëzimit të parcelës | Shfrytëzimi aktual i parcelës | Klasa e cilësisë | Sipërfaqja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71914059-10269-0, me sipërfaqe 287 | P-71914059-04287-0 | PRISHTINË | MURAT MEHMETI | 115 | Tokë Ndërtimore | Oborr | | 66 |
| | | | | | Tokë Ndërtimore | Shtëpi-Ndërtese | | 49 |
| | P-71914059-04288-0 | PRISHTINË | VUSHTRRISË | 172 | Tokë Ndërtimore | Shtëpi-Ndërtese | | 100 |
| | | | | | Tokë Ndërtimore | Oborr | | 72 |

## Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për bashkimin e parcelave kadastrale sikur më lart në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij/saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrimin e njësisë/ve së re:
-Manuali dhe regjistri i fletëparaqitjeve 109-2019,
-Kontrata për ndërtimin e përbashkët LRP nr. 6268/17, Ref nr. 1520/17,
-Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0144544/18, dt 07.12.2018,
Në bazë të gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrimin e njësisë/ve së re sipas dispozitave ligjore të cekura më lart.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

Aktvendimi i dorëzohet:
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës

| Zyrtari përgjegjës | Data: 24.04.2019 | Drejtori |
| --- | --- | --- |
| Namon Restelica | | Valbona Osmani Mehmetaj |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Komuna: Prishtinë
Zyra: Zyra kadastrale komunale
Zona Kadastrale: PRISHTINË

Numri referent i lëndës: 011-040/01-0089877n

Në bazë të nenit 8, 13, 14 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/L-013, si dhe nenit 8, 9, 12, 13, 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 për zbatimin e Ligjit për Kadastër, Komiza për punë AKK 2013/02, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për ndarjen e njësisë ve kadastrale, nxjerr këtë:

# AKTVENDIM

APROVOHET – Kërkesa e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për ndarjen e parcelës kadastrale 10269-0, në parcelat e reja: 10269-1 dhe 10269-2, në pronësi të MUSTAFA (JAKUP) PAKASHTICA 1/2, me numër personal 1004146915 dhe BAHRIJE (MUSLI) PAKASHTICA 1/2, me nr. personal 1014596034.

## Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për ndarjen e parcelave kadastrale sikur më lart në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrimin e ndarjeve:
-Manuali dhe regjistri i fletëparaqitjeve 109-2019,
-Kontrata për ndërtim të përbashkët LRP nr. 6268/17; Ref. nr. 1520/17.
-Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0144544/18, dt. 07.12.2018.
Në bazë të gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrimin e ndarjeve sipas dispozitave të cekura më lart.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

**Aktvendimi i dorëzohet:**
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës

Zyrtari përgjegjës
Naimon Restelica ,

Data: 24.04.2019

Drejtori
Valbona Osmani Mehmetaj

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

**Numri referent i lëndës: 011-940/01-0159227/19**

Komuna: **Prishtinë**
Zyre: **Zyra kadastrale komunale**

Në bazë të nenit 8, 13, 14 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/-L-013, si dhe nenit 8, 9, 12, 13, 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 për zbatimin e Ligjit per Kadastër, Korniza për punë AKK 2013/02, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga Gjeodeti i Licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 9, për ndarjen e njësisë/ve kadastrale, nxjerr këtë

# AKTVENDIM

APROVOHET – Kërkesa e parashtruar nga Gjeodeti i Licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 9, për ndarjen e parcelës kadastrale 4289-0, me pronaren Naxhije (Rashit) Hertica , me numër personal 1000748486, sikur vijon:

| Numri kadastrale | Zona Kadastrale | Vendi i quajtur | Sipërfaqja e gjithmbarshme | Të dhënat për gjendjen e re të krijuar | Lloji i shfrytëzimit të parcelës | Shfrytëzimi aktual i parcelës | Klasa e cilësisë | Sipërfaqja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71914059-04289-0 | PRISHTINË | VUSHTRRISË | 189 | P-71914059-04289-1 | Tokë Ndërtimore | Oborr | | 131 |
| | | | | P-71914059-04289-2 | Tokë Ndërtimore | Shtëpi-Ndërtese | | 58 |

## Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Gjeodeti i Licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 9, për ndarjen e parcelave kadastrale sikur më lart në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrimin e ndarjeve:
-Manuali dhe regjistri i fleteparaqitjeve 164-2019.
-Vendimi për Caktimin e Kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0144544/18, dt. 07.12.2018
Në bazë të gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrimin e ndarjeve sipas dispozitave të cekura më lart.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

**Aktvendimi i dorëzohet:**
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kerkesës

**Zyrtari përgjegjës**
**Namon Restelica**

Data: 12.07.2019

**Drejtori**
**Valbona Osmani Mehmetaj**

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Komuna: **Prishtinë**
Zyre: **Zyra kadastrale komunale**
Zona Kadastrale: **PRISHTINË**

**Numri referent i kadës: 011-940/01-0089877n**

Në bazë të nenit 8, 13, 14 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/L-013, si dhe nenit 8, 9, 12, 13, 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 për zbatimin e Ligjit për Kadastër, Korniza për punë AKK 2013/02, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për ndarjen e njësisë/ve kadastrale, nxjerr këtë:

# AKTVENDIM

APROVOHET - Kërkesa e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për ndarjen e parcelës kadastrale 10269 dhe në parcelat e reja: 10269-1 dhe 10269-2, në pronësi të MUSTAFA (JAKUP) PAKASHTICA 1/2, me numer personal 1004146910 dhe BAHRIJE (MUSLI) PAKASHTICA 1/2, me nr. personal 1014596034.

## Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, per ndarjen e parcelave kadastrale sikur më lart në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrimin e ndarjeve:
-Manuali dhe regjistri i fleteparaqitjeve 109-2019.
-Kontrata për ndërtim të përbashkët LRP nr. 6268/17, Ref. nr. 1520/17.
-Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0144544/18, dt. 07.12.2018.
Në bazë të gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrimin e ndarjeve sipas dispozitave të cekura më lart.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

**Aktvendimi i dorëzohet:**
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës

Zyrtari përgjegjës
Nation Restelica

Data: 24.04.2019

Drejtori
Valbona Osmani Mehmetaj

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Komuna: Prishtinë
Zyre: Zyra kadastrale komunale

Numri referent i lëndës: 011-940/01-0089877/19

Në bazë të nenit 13, 14 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/L-013, si dhe nenit 8, 9, 12, 14, 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 për zbatimin e Ligjit për Kadastër, Korniza për punë AKK 2013/02, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për bashkimin e njësisë/ve kadastrale, nxjerr këtë:

# AKTVENDIM

APROVOHET – Kërkesa e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09 për bashkimin e parcelave kadastrale në pronësi të MUSTAFA (JAKUP) PAKASHTICA 1/2, me numër personal 1004146910 dhe BAHRIJE (MUSLI) PAKASHTICA 1/2, me nr. pers. 1014596034, sikur vijon:

| Të dhënat për ejendjen e re të krijuar | Numri kadastrale | Zona Kadastrale | Vendi i quajtur | Sipërfaqja e gjithmbarshme | Lloji i shfrytëzimit të parcelës | Shfrytëzimi aktual i parcelës | Klasa e cilësisë | Sipërfaqja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71914059-10269-0, me sipërfaqe 287 | P-71914059-04287-0 | PRISHTINË | MURAT MEHMETI | 115 | Tokë Ndërtimore | Oborr | | 66 |
| | | | | | Tokë Ndërtimore | Shtepi-Ndertese | | 49 |
| | P-71914059-04288-0 | PRISHTINË | VUSHTRRISE | 172 | Tokë Ndërtimore | Shtëpi-Ndërtese | | 100 |
| | | | | | Tokë Ndërtimore | Oborr | | 72 |

## Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, lic. nr. 09, për bashkimin e parcelave kadastrale sikur më lart në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij/saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrimin e njësisë/ve së re:
-Manuali dhe regjistri i fletëparaqitjeve 109-2019,
-Kontrata për ndërtimin e përbashkët LRP nr. 6268/17, Ref nr. 1520/17,
-Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0144544/18, dt 07.12.2018.
Në bazë të gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrimin e njësisë/ve së re sipas dispozitave ligjore të cekura më lart.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

**Aktvendimi i dorëzohet:**
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës

[illegible]